

Sideral sh.p.k
Pasqyrat Financiare sipas Standardeve
Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Tabela e Përmbajtjes

Raporti i Audituesit të Pavarur	(i)
---------------------------------------	-----

Pasqyrat Financiare

Pasqyra e Pozicionit Financiar.....	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital.....	3
Pasqyra e Flukseve Monetare	4

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare

1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Mjedisi operues	5
3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	6
4. Vlerësimet kritike të kontabilitetit dhe gjykimet në zbatimin e politikave të kontabilitetit	12
5. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara	13
6. Standarde dhe interpretime të reja	13
7. Menaxhimi i rrezikut financiar	14
8. Vlera e drejtë	16
9. Aktivët afatgjatë materiale	17
10. Aktivët afatgjatë jo-materiale	18
11. Aktivë të tjerë afatgjatë	18
12. Inventari	18
13. Llogari të arkëtueshme	18
14. Të arkëtueshme të tjera	20
15. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	20
16. Kapitali aksionar	20
17. Llogari të pagueshme	21
18. Detyrime të tjera	21
19. Provizione	21
20. Hua	22
21. Të ardhura nga shitjet	22
22. Të ardhura të tjera	22
23. Kosto e mallrave të shitura	22
24. Shpenzimet e personelit	23
25. Shpenzime të tjera operative	23
26. Fitime/humbje nga kursi i këmbimit nga aktiviteti operativ	24
27. Të ardhura/(shpenzime) financiare	24
28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	24
29. Related parties	25
30. Angazhimet dhe të drejta të kushtëzuara	26
31. Ngjarje pas datës së raportimit	26

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerit të Sideral SH.P.K.:

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Sideral SH.P.K. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2020, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politikat e rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit (që përfshin edhe Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Informacione të tjera

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera të cilat pritet të na vendosen në dispozicion pas datës së raportit tonë përfshijnë Raportin e Ecurisë së Veprimtarisë, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacionet e tjerat dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më sipër kur të na vendosen në dispozicion dhe, gjatë këtij procesi, të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk pajtohen në mënyrë të rëndësishme me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që ne kemi mbledhur gjatë auditimit, ose nëse informacionet e tjera përmbajnë anomali të rëndësishme.

Ky version i raportit tonë është përkthim i versionit origjinal të përgatitur në gjuhën Angleze. Janë marrë të gjitha masat që përkthimi të jetë një paraqitje sa më e mirë e versionit origjinal. Megjithatë, në lidhje me çështjet e interpretimit të informacionit, këndvështrimet apo opinionet, versioni i raportit tonë në gjuhën origjinale ka përparësi ndaj këtij përkthimi.

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.
Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower 9/1, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al

Kur ne të lexojmë Raportin e Ecurisë së Veprimtarisë, nëse ne arrijmë në përfundimin se në to gjenden anomali të rëndësishme, ne jemi të detyruar t'ia komunikojmë këto çështje drejtimit.

Përgjegjësitë e drejtimit në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomali mund të vijë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të kenë ndikim në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:


- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.



Ne komunikojmë me drejtimin, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.
PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.
Auditues Ligjor
Jonid Lamllari



28 prill 2021

Tiranë, Shqipëri

SIDERAL SH.P.K.*(Vlerat janë të shprehura në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Aktive			
Aktive afatgjata			
Aktivitet afatgjata materiale	9	611,054,503	652,664,959
Aktivitet afatgjata jomateriale	10	138,340	170,891
Aktive të tjera afatgjata	11	408,196	558,709
Totali i aktiveve afatgjata		611,601,039	653,394,559
Aktive afatshkurtra			
Inventari	12	135,856,588	108,493,052
Llogari të arkëtueshme	13	179,943,254	67,694,392
Të arkëtueshme të tjera	14	294,731,684	432,688,394
Tatim fitim i arkëtueshëm		-	2,453,418
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	15	5,342,817	29,209,934
Totali i aktiveve afatshkurtra		615,874,343	640,539,190
Totali i Aktiveve		1,227,475,382	1,293,933,749
Kapitali			
Kapitali aksionar	16	1,160,331,195	1,160,331,195
Humbja e akumuluar		(689,506,810)	(688,537,205)
Rezultati i periudhës		(2,245,311)	(969,605)
Totali i Kapitalit		468,579,074	470,824,385
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	17	254,538,815	214,425,205
Detyrime të tjera	18	3,479,798	17,198,930
Provizione	19	24,090,814	-
Hua	20	471,092,210	591,485,229
Tatim fitim i pagueshëm		5,694,671	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		758,896,308	823,109,364
Totali i detyrimeve		758,896,308	823,109,364
Totali i Kapitalit dhe Detyrimeve		1,227,475,382	1,293,933,749

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtimi më 21 April 2021 dhe nënshkruar në emër të tij nga:

Georgios Tsikandylakis**Administrator****Besi Bakiri****Shefe kontabiliteti**

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënime shpjeguese në faqet 5 - 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SIDERAL SH.P.K.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse**

	Shënime	2020	2019
Të ardhura nga shitjet	21	1,911,811,987	1,618,210,582
Të ardhura të tjera	22	1,781,498	4,053,956
Kosto e mallrave të shitura	23	(1,728,995,179)	(1,487,179,861)
Shpenzimet e personelit	24	(21,529,760)	(23,581,191)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	9,10	(42,278,305)	(42,215,538)
Zhvlerësimi i aktiveve financiare	13	(8,728,353)	-
Shpenzime të tjera operative	25	(69,386,894)	(53,067,058)
(Humbje)/Fitime nga kursi i këmbimit nga aktiviteti operativ	26	(3,349,269)	5,826,087
Fitimi operativ		39,325,725	22,046,977
Fitime nga kursi i këmbimit	27	37,968	7,638,745
Shpenzime financiare	27	(33,460,915)	(25,932,868)
Fitimi përpara tatim fitimit		5,902,778	3,752,854
Shpenzime për tatim fitimin	28	(8,148,089)	(4,722,459)
Humbja për vitin		(2,245,311)	(969,605)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		(2,245,311)	(969,605)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 - 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SIDERAL SH.P.K.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital**

	Kapitali i nënshkruar	Humbjet e akumuluar	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	1,160,331,195	(688,537,205)	471,793,990
Fitimi i vitit	-	(969,605)	(969,605)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	(969,605)	(969,605)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,160,331,195	(689,506,810)	470,824,385
Humbja e vitit	-	(2,245,311)	(2,245,311)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	(2,245,311)	(2,245,311)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,160,331,195	(691,752,121)	468,579,074

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 - 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SIDERAL SH.P.K.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***Pasqyra e Flukseve Monetare**

	Shënime	2020	2019
Flukse monetare nga aktiviteti operativ			
Humbja përpara tatimit		5,902,778	3,752,854
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi dhe zhvlerësimi	9,10	42,278,305	42,215,538
Zhvlerësimi i aktiveve financiare	13	8,728,353	-
Shpenzime interesi	26	22,043,190	24,222,216
Flukse monetare operative përpara ndryshimeve në kapitalin punues		78,952,626	70,190,608
(Rritje)/Rënie në inventarë	12	(27,363,536)	42,519,721
Rënie/(rritje) në llogari arkëtueshme dhe të tjera	11,13,14	17,130,008	(3,716,929)
Rritje/(Rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	17,18	26,394,478	(54,079,954)
Ndryshime në provizione	19	24,090,814	-
Flukset monetare neto nga aktiviteti operativ		119,204,390	54,913,446
Flukse monetare nga aktiviteti investues			
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	9,10	(635,298)	(2,224,831)
Fluke monetare neto të përdoruara nga aktiviteti investues		(635,298)	(2,224,831)
Flukse monetare nga aktiviteti financues			
Interesi i paguar	20	(16,776,776)	(24,222,216)
Shlyerje të huave	20	(137,039,190)	(18,515,031)
Fluke monetare neto të përdoruara nga aktiviteti financues		(153,815,966)	(42,737,247)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit në mjetet monetare	26	11,379,757	(5,928,093)
Rënie/(rritje) neto në mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre		(23,867,117)	4,023,275
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të periudhës	15	29,209,934	25,186,659
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 dhjetor	15	5,342,817	29,209,934

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 - 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Sideral sh.p.k ("Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila është themeluar në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria është një degë e Shoqërisë Sidenor Steel S.A., e cila zotëron 99,45% të aksioneve dhe pjesa e mbetur e aksioneve (0,55%) janë në pronësi të Elvalhacor S.A.. Shuma totale e kapitalit të nënshkruar është 1,160,331,195 mijë lekë, që përbëhet nga 1,160,331 aksione kuota me vlerë nominale 1,000 lekë për aksion.

Aktiviteti kryesor. Aktiviteti kryesor i Shoqërisë konsiston në importet, eksportet, përpunimin dhe riciklimin e materialeve ndërtimore.

Adresa e regjistruar e biznesit: Adresa e regjistruar e Shoqërisë është autostrada Tiranë - Durrës, Km.24, Durrës, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria kishte 13 punonjës (31 dhjetor 2019: 15 punonjës).

2. Mjedisi operues

Shqipëria shfaq karakteristika të një tregu në zhvillim i cili përbëhet nga sektori i shërbimeve, bujqësia dhe industria të cila kontribuojnë në recesionin ekonomik të vendit. Shqipëria është një ekonomi në tranzicion, jo shumë e integruar në flukset globale të kapitalit por që tregon performanca të forta ekonomike. Vendi është ndikuar nga vështirësitë e Eurozonës, e cila është destinacioni i pothuajse 80% të eksporteve të saj dhe investitori më i madh në vend. Ekonomia shqiptare vazhdon të ndikohet nga tensioni i vazhdueshëm politik në rajon dhe sanksionet ndërkombëtare kundër shoqërive apo individëve të caktuar. Gjatë këtij viti, më 12 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli shpërthimin e COVID-19 një pandemi globale.

Në përgjigje të pandemisë, qeveria shqiptare vuri në veprim masa në përpjekje për të frenuar përhapjen dhe ndikimin e COVID-19, të tilla si ndalimin dhe kufizimin e udhëtimeve, karantinën kombëtare, dhe kufizimet në aktivitetin e biznesit, përfshirë dhe mbylljen e përkohëshme të aktivitetit. Këto masa, ndër të tjera, kanë kufizuar rëndë veprimtarinë ekonomike në Shqipëri dhe kanë ndikuar negativisht dhe mund të vazhdojnë të ndikojnë negativisht në bizneset, pjesëmarrësit e tregut, klientët e Shoqërisë, si dhe ekonominë shqiptare dhe globale, për një periudhë të pacaktuar kohore.

Duke parë situatën COVID-19 në Shqipëri, sektori i çelikut konsiderohet se preket në të njëjtën masë ose më pak me shoqëritë e tjera në sektorë të ndryshëm. Shumica e klientëve të Shoqërisë po operojnë në ambient të hapur dhe kërkesat e klientit mbeten në të njëjtat nivele. Kishte një periudhë të shkurtër bllokimi për Shoqërinë, vetëm një javë gjatë marsit, ku më pas Shoqëria vazhdoi normalisht të funksiononte. Nuk kishte ndërprerje në zinxhirin e furnizimit të Shoqërisë. Furnitorët kryesorë janë fabrikat e të njëjtit grup (Sidenor) të cilat ndodhen në Bullgari, Maqedoninë e Veriut dhe Greqi. Bazuar në procedurat e grupit, Shoqëria mbajti disponueshmërinë e parave në nivelin e nevojshëm.

Drejtimi ka marrë masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e operacioneve të Shoqërisë dhe për të mbështetur klientët dhe punonjësit e saj:

- Shoqëria ka ndryshuar mënyrën e komunikimit me partnerët e biznesit dhe pjesëmarrjen në takim, duke përdorur shërbime dixhitale: duke përdorur shërbime dixhitale, në mënyrë që të shmangë kontaktin fizik dhe të respektojë rregullat e distancës sociale.
- Krijimi i një ambienti të sigurt dhe kushteve për mbrojtjen e stafit.

Bazuar në aktivitetin e Shoqërisë, drejtimi i burimeve financiare dhe njerëzore ka arritur të ruajë stabilitetin e Shoqërisë.

Efektet e ardhshme të situatës aktuale ekonomike dhe masat e mësipërme janë e vështirë për t'u parashikuar dhe pritjet dhe vlerësimet aktuale të drejtimit mund të ndryshojnë nga rezultatet aktuale.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël**Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveçse kur thuhet ndryshe (shih Shënimin 5 dhe Shënimin 6 për standardet e reja dhe të ndryshuara të zbatuara nga Shoqëria).

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas bazës së kostos historike.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lekë ("Lekë"), e cila është gjithashtu monedha funksionale e mjedisit ekonomik në të cilin operon Shoqëria.

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma e tyre neto përfshihet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar shumën e njohura dhe ka qëllim që t'i paraqesë ato në bazë neto, ose për realizimin e pasurive dhe shlyerja e detyrimeve në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk kompensohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse pasi nuk kërkohet ose lejohet nga ndonjë Standard i Kontabilitetit ose interpretim i ndonjë politike kontabël të Shoqërisë.

Parimi i vijimësisë

Drejtimi i Shoqërisë ka përgatitur këto pasqyra financiare mbi bazën e parimit të vijimësisë. Shih Shënimin 4 për analizën e përdorur nga Drejtimi.

Monedha funksionale dhe paraqitja

Këto pasqyrat financiare përgatiten në Lekë ("Lekë"), e cila është gjithashtu monedha e mjedisit ekonomik primar në të cilin njësia funksionon.

Të gjitha informacionet financiare të paraqitura në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

Transaksionet dhe gjendjet

Aktivitet dhe detyrimet monetare janë përkthyer në monedhën funksionale të Shoqërisë me kursin e këmbimit zyrtar të Bankës Qendrore të Shqipërisë ("BSH") në fundin përkatës të periudhës së raportimit. Fitimet dhe humbjet e këmbimit valutor që vijnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhën funksionale të Shoqërisë në kurset zyrtare të këmbimit të BSH-së, njihen si fitim ose humbje nga kursi i këmbimit valutor, neto. Fitimet dhe humbjet e këmbimit valutor që kanë të bëjnë me huatë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse si 'të ardhurave ose shpenzime financiare'. Të gjitha fitimet dhe humbjet e tjera të këmbimit valutor paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse si 'Fitimet / humbjet e tjera, neto'. Përkthimi në normat e fundvitit nuk vlen për zërat jo monetarë që maten me kosto historike. Zërat jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj, përfshirë investimet në kapitalin neto, janë përkthyer duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur u përcaktua vlera e drejtë. Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit në zërat jo monetarë të matur me vlerën e drejtë në një valutë të huaj regjistrohen si pjesë e fitimit ose humbjes së vlerës së drejtë.

Aktivitet afatgjata materiale**Njohja dhe matja**

Aktivitet afatgjata materiale maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe provizionet për zhvlerësim, kur kërkohet.

Shpenzimet përfshijnë kostot që lidhen drejtpërsëdrejti me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të punës direkte dhe kostot e tjera që lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e saj të synuar, ç'montimin dhe transferimin e koston së aktiveve, koston e kthimit të aktiveve në vendin e tyre të mëparshëm, si dhe kostot e kapitalizuara të kredisë.

Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme përfshihen në vlerën bartëse të aktivitet ose njihen si një aktiv i veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me artikullin do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e sendit mund të matet në mënyrë të besueshme. Shpenzimet e riparimeve të vogla dhe mirëmbajtja e përditshme shprehen kur ato ndodhin. Kostoja e zëvendësimit të pjesëve kryesore ose komponentëve të sendeve të aktiveve, impianteve dhe pajisjeve kapitalizohen dhe pjesa e zëvendësuar zhvlerësohet.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Në fund të secilës periudhë raportuese, drejtimi vlerëson nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një aktivi ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e nxjerrjes nga përdorimi dhe vlera e tij në përdorim. Vlera kontabël është zvogëluar në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktiv në vitet paraprake shfuqizohet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet nga shitjet përcaktohen duke krahasuar fitimet me vlerën kontabël neto dhe njihen në fitim ose humbje për vitin.

Amortizimi

Toka nuk amortizohet. Amortizimi i zërave të tjerë të aktiveve afatgjata materiale është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për të shpërndarë koston e tyre gjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të tyre:

	Përqindja e amortizimit
Pajisje zyre	20%
Programe kompjuterike	25%
Pajisje motorike	20%
Përmirësimet e ambienteve me qera	Afati kohor më i shkurtër midis jetës së dobishme dhe kohëzgjatjes së kontratës të qirase financiare

Aktivët afatgjata jo-materiale**Njohja dhe matja**

Aktivët afatgjata jo-materiale të blera nga shoqëria maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe provigjionin për zhvlerësim.

Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm kur rritin përfitimet ekonomike të ardhshme nga pasuria specifike me të cilën ato lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë koston e krijimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (humbje ose fitim) në kohën e ndodhjes.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktiveve, duke ulur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare të llogaritjes.

Inventari

Inventarët regjistrohen me vlerën më të ulët ndërmjet koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet në bazë të mesatares së ponderuar. Kostoja e mallrave të gatshme dhe e punës në progres përfshin materialet e papërpunuara, punët e drejtpërdrejta, kostot e tjera të drejtpërdrejta dhe shpenzimet e lidhura me prodhimin (bazuar në kapacitetin normal operativ), por nuk përfshijnë kostot e huamarrjes. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit minus kostoja e vlerësuar të përfundimit dhe shpenzimeve të shitjes.

Instrumentet financiare termat kryesore të matjes

Vlera e drejtë është çmimi që do të merret për të shitur një aktiv ose të paguar për të transferuar një pasiv në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Treguesi më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi në një treg aktiv. Një treg aktiv është ai në të cilin transaksionet për aktivin ose pasivin bëhen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në baza të vazhdueshme. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në një treg aktiv matet si produkt i çmimit të kuotuar për aktivin ose pasivin individual dhe numri i instrumenteve të mbajtura nga Shoqëria. Ky është rasti edhe nëse vëllimi normal i tregtisë ditore të tregut nuk është i mjaftueshëm për të absorbuar sasinë e mbajtur dhe për të vendosur urdhër për të shitur pozicionin në një transaksion të vetëm mund të ndikojë në çmimin e kuotuar.

Teknikat e vlerësimit siç janë modelet e skontimit të flukseve të mjeteve monetare ose modele të bazuara në transaksionet e fundit të krahut të punës ose shqyrtimi i të dhënave financiare të të investuarve përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve të caktuara financiare për të cilat informacioni i çmimeve të tregut të jashtëm nuk është i disponueshëm. Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dy janë teknikat e vlerësimit me të gjitha inputet materiale (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen vetëm në të dhënat e observueshme të tregut (domethënë matja kërkon hyrje të rëndësishme të pakontrollueshme). Transferet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë konsiderohen se kanë ndodhur në fund të periudhës raportuese.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, emetimit ose shitjes së një instrumenti financiar. Një kosto shtesë është ajo që nuk do të kishte ndodhur nëse transaksioni nuk do të kishte ndodhur. Kostot e transaksionit përfshijnë tarifat dhe komisionet që u paguhen agjentëve (përfshirë punonjësit që veprojnë si agjentë shitës), këshilltarët, agjentët dhe tregtarët, taksat nga agjencitë rregullatore dhe shkëmbimet e letrave me vlerë dhe transferimin e taksave dhe detyrimeve. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet e borxheve ose zbritjet, kostot e financimit ose shpenzimet e brendshme administrative ose të mbajtjes.

Kostoja e amortizuar ("KA") është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në njohjen fillestare duke zbritur çdo ripagim kryesor, plus interesin e përlllogaritur dhe për aktivet financiare minus çdo kompensim për humbjet e pritshme të kredisë ("HPK"). Interesi i përlllogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në njohjen fillestare dhe të çdo primi ose zbritje në shumën e maturimit duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e akumuluar të interesit dhe shpenzimet e interesit të përlllogaritur, duke përfshirë edhe kuponin e akumuluar dhe zbritjen ose shpërblimin e amortizuar (përfshirë tarifat e shtyra në fillim, nëse ka), nuk paraqiten veças dhe përfshihen në vlerat bartëse të zërave në pasqyrën e pozicionit financiar.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e ndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë periodike konstante e interesit (norma efektive e interesit) në vlerën kontabël. Norma efektive e interesit është norma që zbret pagesat e ardhshme të parasë ose faturat (duke përfshirë humbjet e ardhshme të kredisë) nëpërmjet jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël neto të instrumentit financiar. Norma efektive e interesit zbret fluksin e mjeteve monetare të instrumenteve me interes të ndryshueshëm deri në datën e ardhshme të interesit, përveç primeve ose zbritjes që pasqyrojnë diferencën e kredisë mbi normën e variueshme të specifikuar në instrument ose variabla të tjerë që nuk rivendosen në normat e tregut. Primet ose zbritjet e tilla amortizohen gjatë tërë jetës së pritshme të instrumentit. Llogaritja e vlerës aktuale përfshin të gjitha pagesat e paguara ose të marra midis palëve në kontratë që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit.

Instrumentet financiare – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ("VDNFH") fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e zbritshme për humbje të pritshme të kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGJ"), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Të gjitha blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen brenda afatit kohor të përcaktuar me rregullim ose konventë të tregut ("blerje dhe shitje" në mënyrë të rregullt) regjistrohen në datën e tregtimit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet për të dhënë një aktiv financiar. Të gjitha blerjet e tjera njihen kur njëسيا ekonomike bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja e mepasme – kategoritë e matjes. Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA (sipas paragrafit më lart. Klasifikimi dhe matja e mepasme e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) Modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve dhe (ii) karakteristikat e fluksit monetar të aktivit.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja e mepasme – modeli i biznesit. Modeli i biznesit reflekton mënyrën sesi Shoqëria menaxhon aktivet për të gjeneruar fluks monetar – nëse objektivi i Shoqërisë është: (i) vetëm mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale ("mbajtja për mbledhje e flukseve monetare") ose (ii) mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe të flukseve monetare që gjenerohen nga shitja e aktiveve ("mbajtja për mbledhje e flukseve monetare dhe shitje") ose, nëse objektivi (i) dhe (ii) është jo i aplikueshëm, aktivet financiare klasifikohen si pjesë e modelit të biznesit "të tjera" dhe maten në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet financiare individuale (në nivel individual) bazuar në të gjithë evidencën përkatëse për aktivitetet që Shoqëria ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin individual në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga Shoqëria në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si kompensohen menaxherët.

Referojuni Shënimit 4 për gjykimet kritike të aplikuara nga Shoqëria në përcaktimin e modeleve të biznesit për aktivet e saj financiare.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja e mëpasme – karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare. Kur modeli i biznesit ka si objekt mbajtjen e aktiveve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale ose mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe për të shitur, Shoqëria vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë këtij vlerësimi, Shoqëria konsideron nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, pra interesi përfshin vetëm shumën për riskun e kredisë, vlerën kohore të parasë, risqet e tjera bazë të huadhënies dhe marzhin e fitimit.

Aktivet financiare – riklasifikimi. Instrumentet financiare riklasifikohen vetëm kur modeli i biznesit për menaxhimin e portofolit në tërësi ndryshon. Riklasifikimi ka një efekt të ardhshëm dhe zhvillohet që nga fillimi i periudhës së parë të raportimit që vijon pas ndryshimit të modelit të biznesit. Shoqëria nuk ka ndryshuar modelin e saj të biznesit gjatë periudhës aktuale dhe asaj krahasuese, dhe nuk ka bërë ndonjë riklasifikim.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare - provizion për humbjen e kredisë nga HPK. Humbja e pritshme e kredisë llogaritet duke përdorur metodën e thjeshtuar të zhvlerësimit, duke matur jetëgjatësinë e HPK.

Aktivet financiare dhe ekspozimet e tjera të rrezikut nuk duhet të monitorohen për ndryshimet në rrezikun e kredisë me kalimin e kohës, por kompensimi i humbjeve për këto ekspozime rreziku gjithmonë njihet në datën e raportimit në vlerën aktuale të humbjeve të pritshme përgjatë gjithë jetës ("HPK PGJJ").

Lutemi referohuni në Shënimin 4 "Vlerësim dhe gjykime të rëndësishme kontabël" normat e HPK të aplikuara nga Shoqëria.

Financial assets – write-off. Financial assets are written-off, in whole or in part, when the Company exhausted all practical recovery efforts and has concluded that there is no reasonable expectation of recovery. The write-off represents a derecognition event. The Company may write-off financial assets that are still subject to enforcement activity when the Company seeks to recover amounts that are contractually due, however, there is no reasonable expectation of recovery.

Aktivet financiare – çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) aktivet shlyhen ose të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet përfundojnë ose (b) shoqëria ka transferuar të drejtat për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje likuidimi ndërkohë që (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ruan kontrollin e këtyre aktiveve. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura në kosto amortizimi.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato likuidohen (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë paguhet, anulohet ose skadon).

Kompesimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompesohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për netimin e shumave të njohura dhe ekziston qëllimi për shlyerje në baza neto ose realizimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë kompesimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjorisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast mospagese dhe (iii) në rast të paaftësisë paguese ose falimentimit.

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera. Llogaritë e arkëtueshmet dhe të tjera janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë dhe në vazhdim mbarten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre. Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbahen në KA sepse: (i) ato mbahen për mbledhjen e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe këto flukse monetare kontraktuale reflektojnë VPPI (ii) dhe nuk janë të dizenuara me VDNFH.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet në vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera njihen kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj të performancës sipas kontratës dhe matet fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas mbahet me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Qiraja operative. Kur Shoqëria është qiradhënës në një qira e cila nuk transferon të gjitha rreziqet dhe përfitimet tek qiramarrësi, pagesat e qirasë njihen sit ë ardhura të tjera në baze lineare.

Huatë. Huatë njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur kostot e transaksionit dhe më pas mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Garancitë financiare. Garancitë financiare janë kontrata të parevokueshme që kërkojnë nga Shoqëria që të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin e garancisë për një humbje që ka për shkak se një debitor i specifikuar nuk arrin të bëjë pagesën në kohën e duhur në përputhje me kushtet e një instrumenti borxhi. Garancitë financiare fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të pranuar. Kjo shumë amortizohet në bazë lineare gjatë jetës së garancisë. Në fund të secilës periudhë raportuese, garancitë maten me vlerën më të lartë midis (i) shumës së lejuar së humbjes për ekspozimin e garantuar të përcaktuar bazuar në modelin e pritur të humbjes dhe (ii) gjendja e mbetur e paamortizuar së shumës në njohjen fillestare.

Instrumente të tjera financiare

Instrumentet financiare jo-derivative maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi.

Provizionet

Provizionet për detyrimet janë detyrime jofinanciare me kohë ose shuma të pasigurta. Ato janë përlllogaritur kur Shoqëria ka një detyrim aktual ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara, është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitimet ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin dhe një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit mund të bëhet. Provizionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që pritet të kërkohej për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Rritja në provizion për shkak të kalimit të kohës njihet si një shpenzim interesi.

Taksat dhe detyrimet, të tilla si tatimi përveç tatimit mbi të ardhurat ose tarifatat rregullatore të bazuara në informacionet që lidhen me një periudhë para lindjes së detyrimit për të paguar, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja detyruese që shkakton pagesën e taksës, siç përcaktohet nga legjislacioni që shkakton detyrimin për të paguar taksën. Nëse një taksë paguhet përpara ngjarjes detyruese, ajo njihet si parapagim.

Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumat e arkëtueshme për mallrat e furnizuara, të deklaruara neto nga zbritjet, kthimet dhe tatimet mbi vlerën e shtuar.

Shoqëria njeh të ardhurat kur shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme do të rrjedhin tek njësi ekonomike; dhe kur janë përmbushur kriteret specifike për secilën nga aktivitetet e Shoqërisë, siç përshkruhet më poshtë. Kur vlera e drejtë e mallrave të marra në një transaksion shkëmbimi nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, të ardhurat maten me vlerën e drejtë të mallrave ose shërbimit të dhënë.

Shitjet e mallrave. Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen në pikën e transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë së mallrave, normalisht kur mallrat janë dërguar. Nëse Shoqëria pranon të transportojë mallra në një vend të caktuar, të ardhurat njihen kur mallrat i kalojnë klientit në pikën e dorëzimit.

Shitjet e shërbimeve. Shitjet e shërbimeve njihen në periudhën kontabël në të cilën shërbimet kryhen duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit specifik të vlerësuar në bazë të shërbimit aktual të ofruar si pjesë e shërbimeve totale që duhet të ofrohen.

Të ardhurat nga interesi. Të ardhurat nga interesi njihen në bazë të përqindjes kohore duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Përfitimet e punonjësve

Gjatë rrjedhës normale të ecurisë së biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe punonjësve për kontribute sociale dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme sipas legjislacionit shqiptar. Këto kosto lindin në emër të Shoqërisë dhe njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në kohën e ndodhjes.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi në fondet e investuara në depozitat bankare dhe të ardhurat nga kursi i këmbimit.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit për huatë, shpenzimet nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim ose humbje nga rënia e vlerës së aktiveve financiare.

Humbjet ose fitimet në kursin e këmbimit janë paraqitur në neto.

Shpenzimet e tatimit fitimit

Tatimet mbi fitimin janë parashikuar në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin e miratuar ose të nxjerrë në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese. Ngarkesa e tatimit mbi fitimin përbën tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në fitim ose humbje për vitin, përveç nëse ajo njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital sepse lidhet me transaksionet që njihen gjithashtu, në të njëjtën ose në një tjetër periudhë, në të ardhura të tjera përmbledhëse ose direkt në kapital.

Tatimi aktual është shuma që pritet të paguhet ose të rimburohet nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat aktuale dhe të mëparshme. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësimet nëse pasqyrat financiare janë të autorizuar para se të dorëzojnë deklaratat përkatëse tatimore. Tatimet përveç të ardhurave regjistrohen brenda shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë i fitimit sigurohet duke përdorur metodën e pasivit të bilancit për humbjet tatimore të bartura dhe diferencat e përkohshme që lindin midis bazës tatimore të aktiveve dhe pasiveve dhe vlerave të tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar. Në përputhje me përjashtimin fillestar të njohjes, tatimet e shtyra nuk regjistrohen për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të një aktivi ose një pasivi në një transaksion tjetër nga një kombinim biznesi nëse transaksioni, kur regjistrohet fillimisht, nuk ndikon as në kontabilitet, as fitim të tatueshëm. Shumat tatimore të shtyra janë matur me normat tatimore të miratuara ose të vendosura në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të zbatohen në periudhën kur do të ndryshojnë diferencat e përkohshme ose do të përdoret humbja tatimore përpara.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet tatimore që barten në të ardhurat regjistrohen vetëm deri në masën që është e mundur që diferenca e përkohshme të kthehet në të ardhmen dhe ekziston fitimi i mjaftueshëm i ardhshëm i tatueshëm në të cilin mund të shfrytëzohen zbritjet.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e aktiveve tatimore aktuale kundrejt detyrimeve tatimore aktuale dhe kur aktivitet dhe detyrimet e tatimit të shtyrë të të ardhurave kanë të bëjnë me tatimet mbi të ardhurat e mbledhura nga i njëjti autoritet tatimor në njësinë e njëjtë tatimore ose subjekte të ndryshme të tatueshme ku ka një qëllim për të shlyer gjendjet në baza neto.

Shoqëria në vitin 2018 ka njohur aktive tatimore të shtyra për humbjet e mbartura nga 31 dhjetor 2016 (31,483,057 lekë) në shumën 4,722,459 lekë, të cilat u sistemuan në rezultatin e vitit 2019, ku nuk mund të mbartet për në vitet në vazhdim pasi kaloi periudha 3 vjeçare e mbartjes së humbjes.

Tatimi mbi vlerën e shtuar

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) të produktit që lidhet me shitjet paguhet tek autoritetet tatimore në momentin më të herët nga (a) mbledhja e të arkëtueshmeve nga konsumatorët ose (b) dërgimin e mallrave ose shërbimeve ndaj klientëve. TVSH-ja e inuteve në përgjithësi mund të rikthehet kundrejt TVSH-së së prodhimit pas marrjes së faturës së TVSH-së. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së në baza neto. TVSH-ja në lidhje me shitjet dhe blerjet njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në baza neto. Kur është bërë provigjion për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve, humbja nga zhvlerësimi regjistrohet për shumën bruto të debitorit, duke përfshirë TVSH-në.

4. Vlerësimet kritike të kontabilitetit dhe gjykimet në zbatimin e politikave të kontabilitetit

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerat kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar.

Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e menaxhimit dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme sipas rrethanave. Menaxhimi gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim domethënës në vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

Parimi i vijimësisë. Drejtimi i Shoqërisë ka përgatitur këto pasqyra financiare mbi bazën e parimit të vijimësisë. Në bazë të këtij gjykimi, Drejtimi konsideroi pozicionin financiar të Shoqërisë, Fitimin operacional, planet e biznesit dhe burimet financiare, dhe analizoi ndikimin e zhvillimeve makroekonomike në operacionet e Shoqërisë, përfshirë ngjarjet pas periudhës së raportimit (Shënimi 31).

Shoqëria ka patur humbje prej 2,245,311 Lekë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 (2019 humbje: 969,605 Lekë). Flukset monetare hyrëse nga aktiviteti operativ për vitin arritën në 119,204,390 lekë (2019: Flukset monetare hyrëse prej 54,913,446 lekë). Detyrimet aktuale tejkalojnë aktivet e saj aktuale me 143,021,965 Lekë më 31 dhjetor 2020 (2019: tejkalim me 182,570,174 Lekë).

Shoqëria vazhdon të gjenerojë flukse hyrëse parash nga aktivitetet e saj operative në vitin 2020 dhe pret që të vazhdojë edhe në të ardhmen. Shoqëria ishte në gjendje të gjeneronte fitim përpara tatimit prej 39,325,725 Lekë (2019: 22,046,977 Lekë). Drejtimi beson se Shoqëria do të vazhdojë aktivitetin e saj për të ardhmen e parashikueshme dhe do të jetë në gjendje të realizojë aktivet dhe detyrimet dhe angazhimet e saj në rrjedhën normale të biznesit. Prandaj, këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijueshmërisë.

Përveç kësaj, detyrimet tregtare aktuale janë marrë ekskluzivisht nga shoqëria mëmë Sidenor Steel Industry S.A, dhe për limitin e kredisë me bankën Alpha. Shoqëria ka premtuar të gjithë inventarin dhe shumën e të arkëtueshmeve si garanci për pagesën e detyrimit të saj të ardhshëm. Rrjedhimisht, Shoqëria nuk është e ekspozuar për likuidimin e detyrimeve të saj.

Zhvlerësimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe arkëtueshmeve të tjera. Shoqëria zbaton metodën e thjeshtuar të SNRF 9 për matjen e humbjeve të pritshme të kredisë që përdor një humbje të pritshme për të gjitha të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera. Për të matur humbjet e pritshme të kredisë. Të arkëtueshmet tragëtare dhe të arkëtueshmet e tjera janë grupuar në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut të kredisë dhe ditëve të kaluara. Normat e pritshme të humbjeve bazohen në profilet e pagesave të shitjeve gjatë një periudhe dhe humbjet historike përkatëse të kreditit të ndodhura brenda kësaj periudhe. Normat historike të humbjeve janë përshtatur për të pasqyruar informacionin aktual dhe të ardhshëm të faktorëve makroekonomikë që ndikojnë në aftësinë e klientëve për të shlyer llogaritë e arkëtueshme. Pagesa e humbjes së kredisë për llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera përcaktohet sipas matricës së provizionit, niveleve të humbjeve dhe HPK për vitin që përfundon 2020.

5. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

Ndryshime në SNRF 16 për koncesionet e qirave të lidhura me COVID-19, lëshuar në 28 maj 2020 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 qershorit 2020. Ky ndryshim u siguron qiramarrësve lehtësim në formën e një përjashtimi opsional nga vlerësimi nëse një koncesion qiraje në lidhje me COVID-19 është një modifikim i qirasë. Qiradhënësit mund të zgjedhin t'i trajtojnë koncesionet e qirasë sikur të mos ishin modifikime të qirasë. Përshtatshmëria praktike zbatohet vetëm për koncesionet e qirasë që ndodhin si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë së COVID-19 dhe vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme: ndryshimi në pagesat e qirasë rezultojnë në shqyrtimin e rishikuar të qirasë që është në thelb e njëjtë me, ose më pak se, shumat për qiranë që i paraprinë menjëherë ndryshimit; çdo ulje e pagesave të qirasë ndikon vetëm në pagesat e pagueshme më ose para 30 qershorit 2021; dhe nuk ka asnjë ndryshim thelbësor në termat dhe kushtet e tjera të qirasë.

Efekti nga SNRF 16, Qiratë ishte 375,444 Lekë më 1 janari 2019 dhe 3,360,839 Lekë më 31 dhjetor 2019 dhe 6,060,617 Lekë më 31 dhjetor 2020. Shoqëria vendosi të mos njohë Aktiv me të drejtë përdorimi dhe Detyrimin e qirasë pasi shumat nuk janë materiale.

Ndryshimet në standardet e mëposhtme u bënë efektive nga 1 janari 2020, por nuk patën ndikim të rëndësishëm në Shoqëri:

- Ndryshimet në Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar (publikuar më 29 mars 2018 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Ndryshimet në SNRF 3 - Përkufizimi i një biznesi (publikuar më 22 tetor 2018 dhe efektive për blerjet nga fillimi i periudhës raportuese që fillon më ose pas 1 janarit 2020).
- Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 - Përkufizimi i materialitetit (publikuar më 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7 – Reforma e nivelit për përqindjen e interesit (publikuar më 26 shtator 2019 and efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).

6. Standarde dhe interpretime të reja

Janë botuar disa standarde dhe interpretime të reja që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2021 ose më vonë, dhe të cilat Shoqëria nuk i ka adoptuar herët.

- Shitja ose Kontributi i Aktiveve ndërmjet një investitori dhe një sipërmarrjeje të përbashkët ose sipërmarrjeje të tij - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (lëshuar më 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një datë që do të përcaktohet nga BSNK).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" (lëshuar më 18 maj 2017 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtër ose afatgjatë - Ndryshime në SNK 1 (lëshuar më 23 janar 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).
- Ë ardhurat përpara përdorimit të synuar, Kontratat e Rendesishme - kostoja e përbushjes së një kontrate, Referenca në Kuadrin Konceptual - ndryshime të fushës së ngushtë në SNK 16, SNK 37 dhe SNRF 3, dhe Përmirësimet Vjetore të SNRF-ve 2018-2020 - ndryshime në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41 (lëshuar në 14 maj 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).
- Koncesionet e Qirave që lidhen me COVID-19 - Ndryshime në SNRF 16 (lëshuar më 28 maj 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 qershorit 2020).
- Ndryshimet në SNRF 17 dhe një ndryshim në SNRF 4 (lëshuar më 25 qershor 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtër, shtyrja e datës efektive - Ndryshimet në SNK 1 (lëshuar më 15 korrik 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).
- Reforma e normës së interesit (IBOR) - ndryshimet në fazën 2 të SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16 (lëshuar më 27 gusht 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- Shitja ose Kontributi i Aktiveve ndërmjet një Investitori dhe Ortakut të tij ose Sipërmarrjes së Përbashkët - Shoqëria ka kryer një analizë paraprake dhe ka përcaktuar që standardet dhe prononcimet e mësipërme nuk priten të kenë një ndikim të rëndësishëm në llogaritë e Shoqërisë dhe rezultatet e operacioneve.

Nëse nuk përshkruhet ndryshe më lart, standardet dhe interpretimet e reja nuk priten të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

7. Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve të saj financiarë:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj ndonjë prej rreziqeve të mësipërme, objektivave të Shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen e riskut dhe menaxhimin dhe menaxhimin e kapitalit të Shoqërisë. Shënimet e tjera sasiore përfshihen në këto pasqyra financiare. Drejtimi ka përgjegjësi të plotë për hartimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë të dizajnuara për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që hasin shoqëritë, për të vendosur kufijtë e duhur dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e kufijve të përcaktuar. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimit dhe standardeve dhe procedurave të saj të menaxhimit synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv në të cilin të gjithë punonjësit janë të vetëdijshëm për rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentet kryesore financiare të shoqërisë përbëhen nga paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme, të arkëtueshmet dhe të pagueshmet e tjera të pagueshme.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kreditit është rreziku që njëra prej palëve të mos përmbushë detyrimet e kontratave financiare ose të konsumatorëve, duke shkaktuar humbje financiare. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë lind si rezultat i shitjeve të produkteve të Shoqërisë në kushte krediti dhe transaksioneve të tjera me palët që sjellin aktivet financiare, duke përfshirë edhe depozitat në banka dhe institucione financiare dhe derivateve.

Rreziku i kredisë menaxhohet duke i kërkuar klientit të paguajë urdhrin e shitjes si parapagim. Cilësia e kredisë e një klienti vlerësohet bazuar në një kartë krediti kreditimi me vlerësime gjithëpërfshirëse në kohën e nënshkrimit të një marrëveshjeje. Shuma e shitjes e cila është e papaguar (e arkëtueshme) monitorohet rregullisht. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë në datën e raportimit është vlera kontabël e secilës klasë të aktiveve financiare.

Më 31 dhjetor 2020, Shoqëria nuk është e ekspozuar në mënyrë të konsiderueshme ndaj rrezikut të kredisë.

Më 31 dhjetor 2020, Shoqëria nuk ka instrumente financiare kur një klient ose palë në një instrument financiar mund të dështojë në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale. Vlera kontabël e aktiveve financiare paraqet ekspozimin maksimal ndaj rrezikut të kredisë. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë në datën e raportimit ishte:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të arkëtueshme	179,943,254	67,694,392
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	5,342,817	29,209,934
Totali i ekspozimit nga rreziku i kredisë	185,286,071	96,904,326

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet e saj financiare që duhet të shlyhen me mjete monetare ose me një aktiv financiar tjetër. Qëllimi i Shoqërisë në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë që gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet në kohë, si në kushte normale ashtu edhe në kushte të vështira, pa ndonjë humbje të papranueshme ose rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë.

SIDERAL SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***7. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Më poshtë janë paraqitur maturitetet kontraktuale të aktiveve dhe detyrimeve financiare duke përfshirë pagesat e interesave më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

31 dhjetor 2020	1-12 muaj	1-5 vite
Aktive financiare		
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	5,342,817	-
Llogari të arkëtueshme	157,517,070	22,426,184
Totali i Aktiveve financiare	162,859,887	22,426,184
Detyrime financiare		
Detyrime kundrejt palëve të lidhura	227,138,138	19,997,610
Llogari të pagueshme dhe të pagueshme të tjera (duke mos përfshirë palët e lidhura)	10,882,865	-
Huatë afatshkurtra	471,092,210	-
Totali i Detyrimeve financiare	709,113,213	19,997,610
Hendeku i likuiditetit neto	(546,253,326)	2,428,574
31 dhjetor 2019	1-12 muaj	1-5 vite
Aktive financiare		
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	29,209,934	-
Llogari të arkëtueshme	49,644,420	18,049,972
Totali i Aktiveve financiare	78,854,354	18,049,972
Detyrime financiare		
Detyrime kundrejt palëve të lidhura	181,115,407	23,695,059
Llogari të pagueshme dhe të pagueshme të tjera (duke mos përfshirë palët e lidhura)	26,813,669	-
Huatë afatshkurtra	591,485,229	-
Totali i Detyrimeve financiare	799,414,305	23,695,059
Hendeku i likuiditetit neto	(720,559,951)	(5,645,087)

Shoqëria nuk ka politika dhe procedura formale për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në nivel lokal, pasi rreziqet menaxhohen në nivel grupi.

Bazuar në tabelën e mësipërme, Shoqëria nuk ka mjete të mjaftueshme qarkulluese për të mbuluar detyrimet aktuale. Detyrimet janë kryesisht me Sidenor Steel Industry S.A Greece, shoqëria mëmë, SOVEL S.A dhe Stomana Industry S.A të cilat janë palë të lidhura. Sidenor Steel Industry S.A, shoqëria mëmë vazhdon të ofrojë bashkëpunim dhe mbështetje financiare për Sideral sh.p.k. në rast të mungesave të parave të nevojshme. Prandaj, kërkesa e menjëhershme e pagesës së detyrimeve ndaj palëve të lidhura shmanget. Shqetësimi kryesor është drejt shumave të pagueshme palëve të treta, përveç palëve të lidhura.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i ndryshimit të çmimeve të tregut, të tilla si normat e interesit, çmimet e këmbimit dhe çmimet e kapitalit do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose në vlerën e instrumenteve financiare. Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të tregut është menaxhimi dhe kontrolli i ekspozimit ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar të ardhurat.

SIDERAL SH.P.K.**Shënime shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***7. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****Rreziku i tregut (vazhdim)***Rreziku nga kursit të këmbimit*

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit si rezultat i luhatjeve të mundshme në kurset e këmbimit në drejtim të transaksioneve në valutë të huaj. Shoqëria ka bilanc të konsiderueshëm në euro kundrejt furnitorëve dhe kreditorëve, të cilat e ekspozojnë Shoqërinë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Rreziku i ekspozimit të Shoqërisë ndaj kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	Vlera historike	Lekë	Euro
31 dhjetor 2020			
Llogari të arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera	474,674,938	294,731,684	179,943,254
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	5,342,817	667,514	4,675,303
Llogari të pagueshme dhe të pagueshme të tjera	(257,526,942)	(5,047,863)	(252,479,079)
Hua afatshkurta	(471,092,210)	-	(471,092,210)
Totali	(248,601,397)	290,351,335	(538,952,732)

	Vlera historike	Lekë	Euro
31 dhjetor 2019			
Llogari të arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera	502,836,204	435,141,812	67,694,392
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	29,209,934	990,943	28,218,991
Llogari të pagueshme dhe të pagueshme të tjera	(217,040,609)	(12,155,688)	(204,884,921)
Hua afatshkurta	(591,485,229)	-	(591,485,229)
Totali	(276,479,700)	423,977,067	(700,456,767)

Në përgjithësi, Shoqëria ka hendek të madh të rrezikut nga kursi i këmbimit. Hendeku i madh lidhet kryesisht me hendekun e likuiditetit, në vend të hendekut rrezikut nga kursi i këmbimit (referojuni shënimeve të rrezikut të likuiditetit). Shoqëria nuk ka politika dhe procedura formale për administrimin e këmbimit valutor në nivel lokal, pasi rreziqet menaxhohen në nivel grupi. Më poshtë janë paraqitur kurset e këmbimit të aplikuara gjatë vitit:

	Kursi mesatar i këmbimit		Kursi i këmbimit në fund te vitit	
	2020	2019	2020	2019
1 EUR/LEKË	123.77	123.01	123.7	121.77

Analiza e ndjeshmërisë

Në menaxhimin e rrezikut të kursit të këmbimit, Shoqëria synon të zvogëlojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Megjithatë, në periudhën afatgjatë, ndryshimet e përhershme në normat e kursit të këmbimit mund të kenë ndikim në rentabilitetin. Një analizë e ndikimit të parashikuar të ndryshimeve në përqindjen e luhatjeve të vlerës së lekut ndaj monedhave të huaja është paraqitur më poshtë:

Analiza e ndjeshmërisë së monedhës së huaj

Analiza e mëposhtme e ndjeshmërisë përcaktohet bazuar në ekspozimin në valutë në datën e raportimit dhe ndryshimet e llogaritura në fillim të vitit financiar të mbajtura konstante gjatë periudhës raportuese. Më poshtë është një përcaktim i efektit të ndryshimeve të kursit të këmbimit në fitimin neto, duke supozuar që të gjitha variablat e tjerë mbeten të vazhdueshme:

	Diferencat në fitimin ose humbjen e vitit	
	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Euro zhvlerësuar/ vlerësuar me 5 %	+/- 26,947,637	+/- 35,022,838

8. Vlera e drejtë

Vlera e drejtë përfaqëson shumën me të cilën mund të shkëmbehet një aktiv ose një detyrim mund të shlyhet në kushtet e tregut të lirë. Vlerat e drejta bazohen në supozimet e menaxhimit të bazuara në profilin e aktiveve dhe detyrimeve.

Detyrimet financiare përcaktohen në norma fleksibël të interesit bazuar në normat e tregut dhe vlera kontabël e tyre është treguesi më i mirë i vlerave të tyre të drejta.

Nuk ka aktive dhe detyrime, vlera e drejtë e të cilave mund të jetë materialisht e ndryshme nga vlera e tyre kontabël. Asnjë nga aktivet ose detyrimet financiare të Shoqërisë nuk matet me vlerën e drejtë.

SIDERAL SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***9. Aktivet afatgjata materiale**

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Pajisje zyre	Totali
<i>Kosto</i>					
Më 1 janar 2019	194,234,664	870,672,694	64,015,712	32,909,044	1,161,832,114
Shtesa	-	1,437,833	-	786,998	2,224,831
Më 31 dhjetor 2019	194,234,664	872,110,527	64,015,712	33,696,042	1,164,056,945
Shtesa	-	-	-	635,298	635,298
Riklasifikim		(10,844,497)	10,844,497	-	-
Më 31 dhjetor 2020	194,234,664	861,266,030	74,860,209	34,331,340	1,164,692,243
<i>Amortizimi i akumuluar</i>					
Më 1 janar 2019	-	(373,631,476)	(64,015,712)	(31,561,811)	(469,208,999)
Amortizimi për vitin	-	(41,441,917)	-	(741,070)	(42,182,987)
Më 31 dhjetor 2019	-	(415,073,393)	(64,015,712)	(32,302,881)	(511,391,986)
Riklasifikim	-	10,762,937	(10,762,937)	-	-
Amortizimi për vitin	-	(41,475,628)	(29,056)	(741,070)	(42,245,754)
Më 31 dhjetor 2020	-	(445,786,084)	(74,807,705)	(33,043,951)	(553,637,740)
<i>Vlera historike</i>					
Më 31 dhjetor 2019	194,234,664	457,037,134	-	1,393,161	652,664,959
Më 31 dhjetor 2020	194,234,664	415,479,946	52,504	1,287,389	611,054,503

SIDERAL SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***10. Aktivet afatgjata jo-materiale**

	Programe Kompjuterike
Kosto	
Më 1 janar 2019	217,005
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2019	217,005
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2020	217,005
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2019	(13,563)
Amortizimi për vitin	(32,551)
Më 31 dhjetor 2019	(46,114)
Amortizimi për vitin	(32,551)
Më 31 dhjetor 2020	(78,665)
Vlera historike	
Më 31 dhjetor 2019	170,891
Më 31 dhjetor 2020	138,340

11. Aktive të tjera afatgjata

Shoqëria ka paguar garanci për automjetet që ka më qëra në shumën 408,196 lekë (2019: 558,709 lekë), garanci e cila do ti kthehet Shoqërisë në përfundim të marrëdhënies ndërmjet tyre.

12. Inventari

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2019
Mallra të përfunduara	74,590,363	108,493,052
Mallra në tranzit	61,266,255	-
Totali	135,856,588	108,493,052

Më 31 dhjetor 2020, Shoqëria ka mallra në tranzit në vlerën 61,266,255 Lekë. Këto mallra hynë në magazinën e Shoqërisë në Janar 2021 dhe u regjistruan në përputhje me rrethanat sipas kushteve të dërgimit të kontratës.

13. Llogari të arkëtueshme

Llogarite e arkëtueshme janë si me poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të arkëtueshme nga klientë të huaj	129,350,559	41,541,956
Të arkëtueshme nga klientë vendas	59,321,048	26,152,436
	188,671,607	67,694,392
Zhvlerësime të llogarive të arkëtueshme	(8,728,353)	-
Totali	179,943,254	67,694,392

Lëvizja në kompensim për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve është paraqitur më poshtë:

	2020	2019
Gjendja në fillim të vitit	-	-
Humbje të njohura për kërkesat e arkëtueshme	(8,728,353)	-
Shuma të fshira gjatë vitit si të pambledhshme	-	-
Gjendja në fund të vitit	(8,728,353)	-

SIDERAL SH.P.K.**Shënime shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***13. Llogari të arkëtueshme (vazhdim)**

Ditëvonesat e llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 vijon si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Deri në 30 ditë	41,910,869	18,219,241
1 deri në 2 muaj	12,964,253	6,669,750
2 deri në 3 muaj	14,237,240	2,822,299
3 deri në 4 muaj	9,762,950	14,048,223
Mbi 4 muaj	109,796,295	25,934,879
Totali	188,671,607	67,694,392

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 llogaritë e arkëtueshme analizohen si me poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	<i>Vlera kontabël bruto</i>	<i>Zhvlerësuar</i>	<i>Vlera kontabël bruto</i>	<i>Zhvlerësuar</i>
Deri në 30 ditë me vonesë	41,910,869	-	18,219,241	-
Në vonesë por të pazhvlerësuara (palë të lidhura)	120,617,360	-	23,736,043	-
Në vonesë por të pazhvlerësuara (klientë vendas)	17,415,025	-	25,739,108	-
Të zhvlerësuara	8,728,353	(8,728,353)	-	-
Totali	188,671,607	(8,728,353)	67,694,392	-

Në vonesë por të pazhvlerësuara (palët e lidhura) përbëhen nga të arkëtueshmet me palët e lidhura, veçanërisht nga Sidenor Steel Industry S.A, Sovel Hellenic S.A, Stomana Industry dhe Etem Albania sh.p.k.

Shoqëria ka marrëveshje rregullimi neto me Sidenor Steel Industry S.A, shoqëri mëmë, të cilat janë të zbatueshme në rast të vonesave. Përveç kësaj, legjislacioni i zbatueshëm lejon që një njësi ekonomike në mënyrë të njëanshme të shlyejë llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshmet tregtare që duhet të paguhen, të shprehura në të njëjtën monedhë dhe të papaguara me të njëjtën palë. Shih Shënimin 29 Palët e lidhura për gjendjen neto midis Shoqërisë dhe palëve të lidhura.

Shoqëria administron rrezikun e kredisë duke ndjekur strategjinë e kompensimit të instrumenteve financiare. Shuma e kaluar i takon të arkëtueshmeve nga Sidenor Steel Industry S.A, Shoqëria mëmë. Prandaj, Shoqëria nuk pret që të marrë shumën e arkëtueshme pasi kjo shumë do të shënohet me shumën e pagueshme në momentin e shlyerjes.

Në vonesë por të pazhvlerësuara (klientët vendas) përbëhet nga të arkëtueshmet me klientët vendas. Në vitin 2019 Shoqëria nuk ka njohur zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme. Në qershor të vitit 2020, Drejti i Shoqërisë vendosi të njohë plotësisht zhvlerësimin për tre klientë vendas. Vlera prej 17,415,023 lekë i përket një klienti lokal, i cili ka gjendjen më të lartë të arkëtueshmeve me mbi 90 ditë vonesë, pas Sidenor Steel Industry (shoqëria mëmë). Ky klient ka një garanci bankare për të gjithë gjendjen e cila është efektive deri më 30.04.2021.

Deri më mars 2021, Shoqëria ka arkëtuar një total prej 37,672,790 lekë. Kjo ka të bëjë me të arkëtueshmet nga klientët e huaj në shumën 5,054,228 lekë dhe të arkëtueshmet nga klientët vendas në shumën 32,618,562 lekë.

SIDERAL SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***14. Të arkëtueshme të tjera**

Të arkëtueshmet e tjera vijojnë si me poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
TVSH e arkëtueshme	283,465,848	419,533,300
Të arkëtueshme nga punonjësit	156,148	152,781
Shpenzime të parapaguara	290,087	137,083
Të arkëtueshme të tjera	10,819,601	12,865,230
Totali	294,731,684	432,688,394

Shuma e arkëtueshme e TVSH-së përbëhet nga TVSH-ja e gjeneruar nga blerja e materialeve si çeliku dhe telat. Shoqëria importon mallrat e përfunduara nga palët e lidhura, prandaj shuma e TVSH-së paguhet tashmë në favor të porosisë. Në bazë të nenit 69 të ligjit të TVSH-së, Shoqëria ka të drejtë të rimbursojë të gjithë shumën e TVSH-së së paguar. Të arkëtueshmet e tjera lidhen me të drejta doganore dhe kupona naftë.

15. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre vijojnë si me poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2018
Mjete monetare në bankë në monedhë të huaj	4,675,303	28,218,991
Mjete monetare në bankë në monedhën vendase	626,282	897,409
Mjete monetare në arkë në monedhën vendase	41,232	93,534
Totali	5,342,817	29,209,934

Cilësia e kredisë së mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre në banka mund të përmbliidhen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

Banka	S&P	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
NBG bank	CCC+	-	-
Alpha bank	CCC+	208,597	467,699
Tirana bank	CCC+	68,509	154,323
Raiffeisen bank	BBB-	3,542,028	14,151,715
Intesa SanPaolo bank	BBB-	-	2,380,278
ABI bank	CCC+	-	517,173
BKT bank	BBB-	1,482,451	11,445,212
Totali		5,301,585	29,116,400

16. Kapitali aksionar**Numri dhe vlera nominale e aksioneve të regjistruara më 31 dhjetor 2020**

Më 31 dhjetor 2020 kapitali aksionar i autorizuar dhe i regjistruar i Shoqërisë ishte 1,160,331,195 Lekë (2019: 1,160,331,195 Lekë), e cila është në pronësi të Sidenor Steel Industry SA me shumën e kapitalit aksionar prej 1,153,947,195 Lekë (99,45%) dhe Elvalhacor S.A me shumën e aksioneve kapital prej 6,384,000 Lekë (0,55%).

Aksionerët

The table below presents the structure of the shareholders of the Company and their contribution made on 31 December 2020 and 31 December 2019.

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
Aksioner	Kapitali në %	Kontributi në Lekë	Kapitali në %	Kontributi në Lekë
Sidenor	99.45%	1,153,947,195	99.45%	1,153,947,195
Elvalhacor S.A	0.55%	6,384,000	0.55%	6,384,000
Totali	100.00%	1,160,331,195	100.00%	1,160,331,195

SIDERAL SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***17. Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme vijnë si me poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve		
- Furnitorë të huaj	252,479,078	204,884,921
- Furnitorë vendas	2,059,737	9,540,284
Totali	254,538,815	214,425,205

Shuma e llogarive të pagueshme për furnizimet e huaja përbëhet nga mallrat e importuara kryesisht nga shoqëria mëmë, Sidenor Steel S.A, nga palët e tjera të lidhura me grupin. Momentalisht, nuk ekziston rreziku i kërkesës së kthimit të menjëhershëm për llogaritë e pagueshme.

Për më tepër, gjatë vitit 2020, Shoqëria ka kryer pagesa të konsiderueshme ndaj palëve të lidhura që kanë të bëjnë me detyrimet e pagueshme deri më tani.

Detyrimet nga palët e lidhura janë analizuar në Shënimin 29. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj likuiditetit dhe rreziqeve të monedhës që vijnë nga llogaritë e pagueshme janë paraqitur në Shënimin 7.

18. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera vijnë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Shpenzime të përlllogaritura	2,550,564	1,934,480
Provizione për kompesimin e punonjësve	491,672	982,000
Kontribute shoqërore dhe shëndetësore të pagueshme	312,570	357,363
Detyrime ndaj tatimit mbi të ardhurat personale	121,258	145,794
Detyrime ndaj tatimit në burim	3,734	1,827
Provizione për skontim	-	13,601,526
Parapagime nga klientët	-	175,940
Totali	3,479,798	17,198,930

19. Provizione

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Provizione	24,090,814	-
Totali	24,090,814	-

Provizioni për detyrimet dhe pagesat përfshijnë provizione për çështjet ligjore si dhe proceset gjyqësore në vazhdim.

Shoqëria (si paditëse) ka një çështje ligjore kundër Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj (si e paditur).

Në vitet e mëparshme, Shoqëria ka patur një kontroll tatimor nga Autoritetet Tatimore me qëllimin e verifikimit të TVSH-së. Sipas vlerësimit të taksave, detyrimet e TVSH-së u ngarkuan për gabimin e Shoqërisë për të lëshuar faturë tatimore dhe për të paguar TVSH-në gjatë viteve të mëparshme për mallrat e shitura dhe u gjobit në shumën prej 24,090,814 lekë.

Shoqëria apeloj vendimin e Autoriteteve Tatimore në Gjykatën Administrative Tiranë duke pretenduar njohjen e së drejtës për të përfutur nga amnistia e gjobës sipas Ligjit Nr. 33/2017 “Detyrimi i palës së paditur për të hequr gjobat në shumën 24,090,814 lekë”. Pretendimi u refuzua nga Gjykata Administrative e Tiranës. Çështja është ende në proces përpara Gjykatës Administrative të Apelit. Në vitin financiar 2020, Sideral sh.p.k. ka njohur një provizion në shumën totale, në lidhje me çështjen.

SIDERAL SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***20. Hua**

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Overdraft bankar	471,092,210	591,485,229
Totali	471,092,210	591,485,229

Shoqëria ka një marrëveshje overdraft-i me Alpha Bank me një limit kredie prej 5,000,000 EUR me një normë interesi prej 4% dhe maturim çdo 1 vit. Maturimi është deri më 31.07.2021 (rinovuar së fundmi me një marrëveshje të re). Shoqëria e përdor shpesh overdraft-in për operimin e biznesit. Overdrafti bankar klasifikohet si aktiv afatshkurtër.

Tabela më poshtë paraqet një analizë të detyrimeve nga aktiviteti financiar dhe lëvizjet në detyrimet e Shoqërisë nga aktiviteti financiar për secilën nga periudhat e paraqitura. Zërat e këtyre detyrimeve janë ato që raportohen si financime në pasqyrën e fluksit të parave:

	Detyrime nga aktiviteti financiar	
	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Më 1 janar	591,485,229	615,928,353
Hua të reja	-	-
Shlyerje të huave	(137,039,190)	(18,515,031)
Rregullime nga këmbimi valutor	11,379,757	(5,928,093)
Shpenzime të interesit	22,043,190	24,222,216
Pagesa të interesit	(16,776,776)	(24,222,216)
Më 31 dhjetor	471,092,210	591,485,229

21. Të ardhura nga shitjet

Shitjet vijnë si me poshtë:

	2020	2019
Mallra të shitura	1,911,811,987	1,631,812,108
Provizion për skontim	-	(13,601,526)
Totali	1,911,811,987	1,618,210,582

Shoqëria blen mallrat përfundimtarë nga Shoqëria mëmë dhe ri-shesin produktet brenda tregjeve vendore dhe të huaja. Shitja e mallrave lidhet me shitjen e produkteve të hekurit, çeliku dhe bakrit, nga të cilat 93.22% janë shitur brenda tregut lokal krahasuar me 6.78% që eksportohen në tregjet e huaja.

22. Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera vijnë si me poshtë:

	2020	2019
Të ardhura nga qiraja	76,613	256,765
Të ardhura nga shërbimet	1,704,885	3,797,191
Totali i të ardhurave të tjera	1,781,498	4,053,956

Të ardhurat nga qiratë lidhen me hapësirën e magazinës me qira të kompanive të grupeve për të ruajtur produktet e tyre. Service income is related with to the brand marketing of the group's products in Albania as well as transport services. Të ardhurat nga shërbimet lidhen me marketingun e markës së produkteve të grupit në Shqipëri si dhe shërbimet e transportit.

23. Kosto e mallrave të shitura

Kostoja e mallrave të shitura përbëhet nga shpenzimet e çmimit të blerjes për mallrat e importuara dhe të transportit nga porosi në depo të Shoqërisë ose në depon e klientëve. Më 31 dhjetor 2020 kostoja e mallrave të shitura ishte 1,728,995,179 Lekë (2019: 1,487,180 Lekë).

SIDERAL SH.P.K.**Shënime shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***24. Shpenzimet e personelit**

Personnel expenses are composed as follows:

	2020	2019
Paga bruto	19,107,767	20,696,603
Kontributet shoqërore dhe shëndetësore	2,421,993	2,884,588
Totali i shpenzimeve të personelit	21,529,760	23,581,191

25. Shpenzime të tjera operative

Shpenzimet e tjera operative vijnë si me poshtë:

	2020	2019
Provizione për çështje në gjykatë	24,090,814	982,000
Konsulencë teknike për SAP	15,238,045	16,099,961
Komisione bankare	3,998,406	4,161,390
Shpenzime sigurie	3,960,000	5,040,000
Shpenzime legale	3,113,857	793,842
Shpenzime sigurimi	2,476,922	2,196,820
Shpenzime qeraje financiare	2,429,072	2,707,312
Blerje energjie elektrike, ujë	2,082,000	2,206,481
Shpenzime të tjera	1,969,176	2,871,577
Shpenzime për taksa	1,960,144	1,930,036
Shpenzime telefonike	1,766,312	1,390,776
Shpenzime transporti	1,452,910	1,929,594
Shpenzime udhëtimi	922,403	2,142,806
Shpenzime transporti të mallrave	873,364	1,437,669
Mirëmbajtje	683,396	1,039,249
Shpenzime zyre	653,592	258,335
Sherbime konsulente	561,792	2,558,467
Shpenzime për testet e Covid 19	441,200	-
Shpenzime karburanti	262,786	310,333
Shpenzime përfaqësimi	146,260	830,855
Shpenzime perkthimi	139,833	82,351
Shpenzime komerciale	58,567	41,474
Shpenzime postare	51,961	-
Shpenzime marketingu	34,882	-
Shpenzime trajnimi	19,200	134,874
Penalitete	-	1,920,856
Totali	69,386,894	53,067,058

Vlera e paraqitur në konsulencën teknike të SAP përfshin mbështetjen e dhënë nga grupi për IT që u ngarkohet të gjitha shoqërive të grupit përmes një pagese menaxhimi. Vlera e paraqitur në Provizione për çështje në gjykatë shpjegohen në shënimin 19.

SIDERAL SH.P.K.**Shënime shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***26. Fitime/humbje nga kursi i këmbimit nga aktiviteti operativ**

Fitime/humbje nga kursi i këmbimit nga aktiviteti operativ vijon si më poshtë:

	2020	2019
Fitime/(humbje) nga kursi i këmbimit për klientët	1,081,657	(289,347)
(Humbje)/fitime nga kursi i këmbimit për furnitorët	(4,430,926)	6,115,434
(Humbje)/fitime neto nga kursi i këmbimit nga aktiviteti operativ	(3,349,269)	5,826,087

27. Të ardhura/(shpenzime) financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare përbëhen si më poshtë:

	2020	2019
Të ardhura financiare		
Të ardhura nga kursi i këmbimit	37,968	7,638,745
Totali i të ardhurave nga kursi i këmbimit	37,968	7,638,745
Shpenzime financiare		
Shpenzime interesi	(22,043,190)	(24,222,216)
Humbje nga kursi i këmbimit	(11,417,725)	(1,710,652)
Totali i shpenzimeve financiare	(33,460,915)	(25,932,868)
(Shpenzime)/të ardhura financiare neto	(33,422,947)	(18,294,123)

28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 vijon si më poshtë:

	2020	2019
Shpenzime për tatim fitimin për periudhën	8,148,089	-
Tatimi i shtyrë	-	4,722,459
Të ardhura nga tatimi i shtyrë	-	(4,722,459)
Totali	8,148,089	-

Shoqëria në vitin 2018 ka njohur aktive tatimore të shtyra për humbjet e mbartura nga 31 dhjetor 2016 (31,483,057 lekë) në shumën 4,722,459 lekë, të cilat u sistemuan në rezultatin e vitit 2019, ku nuk mund të mbartet për në vitet në vazhdim pasi kaloi periudha 3 vjeçare e mbartjes së humbjes.

In accordance with Albanian income tax legislation, the applicable income tax rate for 2019 is 15% (2018 15%). The reconciliation between the expected and actual taxation charge is provided below:

	2020	2019
Fitimi para tatimit	5,902,778	3,752,854
Tatimi mbi fitimin i llogaritur me 15%	885,417	562,928
Shtohet: Shpenzime të panjohura për qëllime të tatimit	7,262,672	3,371,985
Shfrytëzimi i humbjeve tatimore të panjohura më parë, të mbartura	-	(3,934,913)
Humbja/Fitimi tatimor bartur për vitin	-	-
Shpenzimi për tatim fitimin e vitit	8,148,089	-

Në 31 dhjetor 2018 Shoqëria ka zgjedhur të regjistrojë humbjen e mbartur si aktiv tatimorë të shtyrë. Detajet e humbjes tatimore të mbartura janë si më poshtë. Sipas legjislacionit tatimor shqiptar, humbjet mund të mbarten për një periudhë prej tre vjetësh të njëpasnjëshme. Shoqëria ka llogaritur pasuri tatimore të shtyrë për humbjet e krijuara në vitin 2016 në shumën 4,722,459 Lekë të cilat e humbasin efektin në 31.12.2019 (31,483,057 Lekë *15%).

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Humbjet tatimore që mbarten për periudhat pasardhëse do të përfundojnë më: 31 dhjetor 2020	-	-

SIDERAL SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***29. Related parties**

Shoqëria ka transaksione me palët e lidhura gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë së saj. Tabela më poshtë përmbledh llojin dhe volumin e transaksioneve nga palët e lidhura.

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Pozicioni neto Të arkëtueshme / (Të pagueshme)	Të ardhura	Shpenzime
Dojran Steel D.O.O	-	18,784,473	(18,784,473)	-	31,497,693
Elvalhacor	-	20,049,861	(20,049,861)	-	-
Erlikon S.A	-	-	-	1,134,283	-
Etem Albania sh.p.k	556,649	-	556,649	128,275	-
Sidenor Steel Industry S.A	119,976,061	9,509,376	110,466,685	122,814,743	332,300,801
Sidma Steel S.A	-	829,762	(829,762)	1,312,123	-
Sovel Hellenic Steel	4,965,927	197,560,502	(192,594,575)	-	1,195,244,690
Stomana Industry S.A	4,408,572	-	4,408,572	-	149,384,170
Teka System S.A	-	401,774	(401,774)	-	472,397
Viexal S.A	-	-	-	-	682,934
Totali	129,907,208	247,135,748	(117,228,540)	125,389,425	1,709,582,685

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Pozicioni neto Të arkëtueshme / (Të pagueshme)	Të ardhura	Shpenzime
Dojran Steel D.O.O	-	2,609,730	(2,609,730)	-	8,610,989
Elvalhacor	13,956,694	33,693,732	(19,737,038)	13,948,840	8,517,959
Erlikon S.A	-	172,733	(172,733)	-	1,083,173
Etem Albania sh.p.k	397,578	-	397,578	459,799	-
Sidenor Steel Industry S.A	21,806,043	122,078,179	(100,272,136)	21,914,928	985,927,091
Sidma Steel S.A	890,772	-	890,772	3,205,845	-
Sovel Hellenic Steel	4,888,447	16,097,384	(11,208,937)	4,919,026	245,489,139
Stomana Industry S.A	-	29,880,574	(29,880,574)	-	153,866,319
Teka System S.A	-	9,977	(9,977)	-	294,461
Viexal S.A	-	268,157	(268,157)	-	2,053,755
Totali	41,939,534	204,810,466	(162,870,932)	44,448,438	1,405,842,886

Mallrat janë blerë nga shoqëria mëmë me metodën e kostos plus marzh prej 3.64% (2019: 3,64%).

Drejtimi i Shoqërisë përbëhet nga administratorët, respektivisht Z. Charalampos Bartzelis, Z. Efstratios Thomadakis, Z. Christos Batilas dhe Z. Georgios Tsikandylakis.

Pagat dhe përfitimet e drejtimit janë si më poshtë:

	2020	2019
Paga dhe bonuse	1,876,080	3,215,636
Kontribute shoqërore dhe shëndetësore	238,296	415,880
Totali	2,114,376	3,631,516

SIDERAL SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***30. Angazhimet dhe të drejta të kushtëzuara***Angazhimet*

	2020	2019
Deri në 1 vit	1,755,189	1,320,000
Mbi 1 vit por jo më shumë se 5 vite	4,305,428	3,014,000
Mbi 5 vite	-	-
Totali	6,060,617	4,334,000

Angazhimet lidhen me qiratë operative për autoveturat e përdorura nga Shoqëria përgjatë biznesit operativ.

Garancitë

Politika e shitjeve të Shoqërisë kërkon që klientët të parapagujnë për porosinë e mallrave ose ata mund të lëshojnë një garanci për porosinë e kryer me qëllim të dorëzimit të mallrave.

Më 31 dhjetor 2020, Shoqëria ka patur në formën e garancive nga një klient shumë 500,000 Euro me një datë skadence 7 korrik 2021.

Në datën 12 shtator 2020, Shoqëria ka rinovuar një Garanci Bankare nga Alpha Bank sh.a Nr. 3005 Datë 12.09.2019 në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në shumë 12,142,000 lekë për Magazinën Doganore me afat skadence 11 shtator 2021.

Taksat

Gjatë vitit 2019, Shoqëria mori raportin e kontrollit tatimor nr. 8078/6, datë 06.06.2019 me kërkesë të Shoqërisë për rimbursim të TVSH-së në shumë 255,448,596 lekë. Në zbatim të shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave 15467/2, datë 03.08.2018, për periudhat tatimore 06/2015 deri më 12/2017. Ky raport përfshinte njoftimin përkatës të vlerësimit tatimor nr. 8078/5, datë 06.06.2019, të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, duke kërkuar pagimin e detyrimeve tatimore, përkatësisht uljen e gjendjes të kreditit të TVSH-së në 1,247,236 lekë, gjopa në lidhje me TVSH / fitimin tatimor në shumë 623,619 lekë. Drejtimi i Shoqërisë pranoi vlerësimin dhe raportin tatimor. Deri në datën e pasqyrave financiare, Shoqëria është rimbursuar nga Drejtoria e Tatimeve për vlerën e 30,000,000 Lekë në Dhjetor 2019 dhe 143,463,045 Lekë në Janar 2020.

31. Ngjarje pas datës së raportimit

Qeveria shqiptare në 2021 ka njoftuar kufizimet e reja të lëvizjes që do të hyjnë në fuqi duke filluar nga data 11 prill 2021, deri në një njoftim tjetër. Nuk do të lejohet lëvizja çdo ditë pas orës 22:00. Lëvizja publike është e kufizuar gjatë këtyre orëve me përjashtim të arsyeve të punës, emergjencave të kujdesit shëndetësor ose nevojave urgjente. Kufizimet e udhëtimit vazhdojnë të jenë të zbatueshme. Këto zhvillime nuk kanë ndikim në Shoqërinë ose mënyrën se si Drejtimi po e menaxhon situatën. Shoqëria po funksionon normalisht pavarësisht nga kufizimet e lëvizjes.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që kërkojnë shpjegime shtesë ose rregullime në këto pasqyra financiare.